

DOKUMENT UDHËZUES PËR FORMATIN E DEBATEVE ONLINE

Ky dokument i drejtohet studentëve dhe pedagogëve për tu përgatitur për realizimin e debateve online në kushtet e krijuara nga pandemia COVID19.

Zgjedhja e liderit të skuadrës

Katër anëtarët e skuadrës në konsultim me pedagogun mentorues, zgjidhin liderin e skuadrës.

Lideri i skuadrës do të debatojë me liderin e skuadrës kundërshtare.

Kujdes: Të gjithë anëtarët e skuadrës janë pjesëmarrës dhe kanë një hapësirë për të dhënë edhe ata mendimet e tyre pas përfundimit të debatit kokë më kokë të liderëve.

Prandaj, puna përgatitore për leximin e paketës së kërkimit dhe përgatitja së bashku si skuadër ka rëndësi edhe në këtë format.

Anëtarët ndajnë punën për përgatitjen e tematikave duke iu referuar paketës kërkimore dhe duke bërë kërkime të tjera të nevojshme përmes burimeve dytësore (biblioteka, burime online, burime nga pedagogu etj.). Pedagogu lehtëson realizimin e këtij procesi kërkimor.

Ndarja e roleve

SCiDEV do të vendos cila skuadër do të jetë afermative dhe cila opozitare me short më përpara dhe në debatin online secili lider do të mbaj qendrim sipas kësaj ndarjeje. Gjithashtu edhe një nga temat do të përcaktohet paraprakisht. Në fillim të debatit moderatorin do të njoftojë temën dhe ndarjen e liderëve/skuadrave pro dhe kundër. Pra, përgatituni për të 5 temat sipas [Paketës Kërkimor](#).

Lideri i skuadrës afermative mban qendrimin pro dhe paraqet rezolutën pohuese i/e pari(a).

Lideri i skuadrës opozitare ka për detyrë të kundërshtojë rezolutën apo tezën e paraqitur nga afermativi duke u bazuar në evidenca / argumenta dhe të ofrojë një tezë/rezolutë të tyre.



Lideri i skuadër opozitare i kundërpërgjigjet rezolutës: së pari, nëse ka kundërshtim për termat apo konceptet e paraqitura; së dyti, nëse ka kundërshtim në parim me rezolutën; në treti, kundërshtim bazuar në argumenta dhe evidenca.

Moderatori

Debati mes dy liderëve të skuadrave do të moderohet nga pedagogu/ia që është njëkohësisht edhe mentori/ja e skuadrave dhe një moderator i jashtëm (ekspert SCiDEV).

Në fillim të debatit moderatori/pedagogu/ia do të njoftojë temën dhe ndarjen e liderëve/skuadrave pro dhe kundër.

Moderatori/pedagogu/ia do të drejtojë me pyetje konkrete debatin e dy liderëve. Tre janë pyetjet kryesore:

1 – Cili është qëndrimi juaj lidhur me temën “...” (një nga 5 temat sipas dokumentit: [Tematikat e debatit](#))

2 – Si ka ndikuar kriza e pandemisë COVID19 në temën në diskutim?


3 – Cilat janë përfundimet e secilit lider në fund të debatit?

Liderët do të duhet të debatojnë sipas këtyre linjave dhe t'i përgjigjen pyetjeve të tjera nga moderatori gjatë debatit.

Në përfundim të debatit, moderatori i jashtëm (SCiDEV) do të bëjë një përmbledhje të diskutimit, ideve dhe argumenteve të paraqitura.

Rrjedha e debatit me tematikat me përgatitje





Përdorimi i evidencave

Përdorimi i evidencave është shumë i rëndësishëm për të mbështetur argumentet dhe tezat që paraqesin skuadrat.

Evidencat duhet të jenë të sakta dhe me burime serioze dhe të verifikueshme.

Evidencat duhet të përdoren me ndershmëri dhe jo në mënyrë të njëanshme apo me interpretime të pasakta / të rreme.

Skuadra duhet të përdorë evidenca që janë në paketën e kërkimit dhe të bëjë kërkim të mëtijshëm për të pasuruar tezën.

Pas debatit

Skuadrat punojnë më pas të nxjerrin me shkrim argumentat / tezat e tyre në formën e një analize të shkurtër me rekomandime e cila publikohet në [Rubrikën BLOG](#).

